



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Drejtuar:

Këshillit Mësimor-Shkencor të

Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës

Lënda: Përgjigje e Kundërshtimit nga ana e dr. Merita Banjicës në lidhje me Referatin për zgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët mësimore në fushën e gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik, të shpallur në Buletinin e Universitetit të Tetovës, me nr. 188 të datës 27.05.2021

Në lidhje me Kundërshtimin e Referatit të Komisionit Recensues, të parashtruar nga dr. Merita Banjica, Komisioni Recensues e shqyrtoi Kundërshtimin dhe jep:

PËR GJIGJE

Kundërshtimi i dorëzuar nga kandidati dr. Merita Banjica është i pabazë. Komisioni Recensues, duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18), Statutin e Universitetit të Tetovës si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, bëri përzgjedhjen e kandidates dr. Hana Dardhishta.

Gjatë vlerësimit, Komisioni Recensues i është referuar Ligjit për arsimin e lartë. Më konkretisht e kanë zbatuar nenin 166, paragrafi 1, alineja 1 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18) i cili thotë: „(1) Në titullin mësimor –shkencor docent, mund të jetë personi i zgjedhur që: 1. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studime të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël në veçanti, përkatësisht ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studime të integruara të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë“.

Në rastin konkret, dr. Merita Banjica, në ciklin e parë ka notë mesatare **7.30**, ndërsa në ciklin e dytë **7.73**. Ndërsa kandidati dr. Hana Dardhishta në ciklin e parë ka notë mesatare **8.30**, ndërsa në ciklin e dytë **8.60**.

Duke u bazuar në nenin 166, paragrafi 1, alineja 1, vërtetohet se dr. Merita Banjica nuk e plotëson kushtin themelor të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18), prandaj Komisioni Recensues e pa të arsyeshme që aspak të mos bëjë llogaritjen e pikëve në formë tabelare. Sipas nenit 207, paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18): „Komisioni Recensues gjobitet nëse kryen zgjedhje të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (nga neni 166 dhe neni 177)“.

Sa i përket kundërshtimit të kandidates dr. Merita Banjica në lidhje me nenin 166, alineja 5 që thotë: „Për personat që kanë themeluar marrëdhënie pune si docent, profesor inordinar, asistent, asistent doktorant, ose asistent i ri në një nga universitetet në Republikën e Maqedonisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen dispozitat e paragrafit (2) alinesë 1 dhe paragrafit (3) alinesë 1, gjatë



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

zgjedhjes së tyre në titullin e njëjtë ose më të lartë mësimor-shkencor, pavarësisht nga cili institucion i arsimit të lartë kryhen zgjedhjet e reja“ vlerësojmë se nuk qëndron, ngase kandidati dr. Merita Banjica nuk posedon thirrje të marrë nga ndonjë universitet në Republikën e Maqedonisë.

PËRFUNDIM ME PROPOZIM

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, Komisioni Recensues konsideron se Kundërshtimi i dr. Merita Banjicës, me nr. 03-2090/1 i datës 14.06.2021 është i pabazë dhe në disa pjesë edhe tendencioz.

Komisioni në përbërje, prof. dr. Izmit DURMISHI (kryetar), prof. dr. Zarije NUREDINI (anëtar) dhe prof. dr. Berton SULEJMANI (anëtar) ka nderin e veçantë që edhe një herë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik t'i propozojë që kandidati Dr. Hana Dardhishta të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent në fushën e gjuhës shqipe**, në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Fakultetit Filologjik.

Tetovë, më 16. VI. 2021

Komisioni Recensues:

1. Prof. dr. Izmit DURMISHI (kryetar) – profesor inordinar
në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

2. Prof. dr. Zarije NUREDINI (anëtar) – profesor inordinar
në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

3. Prof. dr. Berton SULEJMANI (anëtar) – profesor
inordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës